



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 11505 prot.

Vlorë, më 19.07 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2024

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË ZNJ. Evisa MAMUSHI DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh, të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj. Evisa Mamushi, e ndodhur në lagjen “24Maji”, Rajoni Nr.4, Bashkia Vlorë, në datën 04.03.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 76.978 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë për punime ndërtimi (153.955x50%).

B. 194.607 (njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.



2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 11505 prot.

Vlorë, më 19.07 2024

RELACION

PËR


PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E ZNJ. Evisa MAMUSHI DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë date 05.03.2024 ka paraqitur kërkesën znj. Evisa Mamushi me nr. 3515 prot. për shkakë të djegies së banesës e ndodhur në lagjen “24 Maji” Rajoni 4, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr. 15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 01.03.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr. 3515/1 prot, datë 10.06.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të znj. Evisa Mamushi” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr. 3515/2 prot, datë 08.07.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të znj. Evisa Mamushi” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

-  - Vlera e dëmeve në banesën e znj. Evisa Mamushi është 271.585 (dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj. Evisa Mamushi sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Adrian Vreshtazi

